



# **Takimet në Shtërpçë: Udhëheqësit komunalë dhe fetarë**

**Nëntor/Dhjetor 2024**

Përgatitur nga:

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Kontakti: Rr. Major Mehmet Bushi, H. III/1,  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0)38 542 778  
Web-site: [www.kipred.org](http://www.kipred.org)  
Email: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org)

OJQ AKTIV

Kontakti: Str. Kralja Petra I, 183a,  
Mitrovica, Kosovo.  
Tel: +381 (0) 64 310 6660  
Web-site: [www.ngoaktiv.org](http://www.ngoaktiv.org)  
Email: [office@ngoaktiv.org](mailto:office@ngoaktiv.org)

Përkrahur nga:



---

*Informata në këtë botim është dhënë si pjesë e projektit “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë,” i realizuar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) në partneritet me OJQ-në AKTIV, dhe i financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky synon ta ofrojë një pasqyrë të rezultateve dhe diskutimeve nga dialogjet multi-etnike në Shtërpcë. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura këtu janë ato të pjesëmarrësve, dhe nuk i pasqyrojnë detyrimisht politikën dhe qëndrimet zyrtare të KFOS-it.*

## Parathënie

Nisma e shoqërisë civile “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” i përfshin 10 përfaqësues nga komunitetet e shoqërive civile shqiptare dhe serbe, të udhëhequr nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me seli në Prishtinë, dhe OJQ-ja AKTIV me seli në Mitrovicën e Veriut. Kjo nismë është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” synon ta forcojë dialogun, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, dhe t’i kontribuojë bashkëjetesës ndëretnike në Kosovë.

Një aspekt i veçantë i kësaj nisme janë “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve,” të shkruara nga pjesëmarrësit e Karvanit. Këto letra i shprehin shpresat dhe vizionet e tyre për bashkëjetesë dhe respektim të ndërsjellë midis grupeve të ndryshme etnike. Këto shërbejnë si një bazë për diskutimet tona me kryetarët e komunave dhe me udhëheqësit fetarë, dhe po ashtu përfshijnë edhe sugjerimet për përmirësimin e marrëdhënieve dhe për bashkëjetesën midis komuniteteve etnike.

Ju ftojme t’i përkrahni qëllimet e kësaj nisme për forcimin e themeleve dhe ndërtimin e një shoqërie multietnike, demokratike dhe liberale në Kosovë.

*Lulzim Peci*  
*Drejtor Ekzekutiv*  
*KIPRED*

*Miodrag Miličević*  
*Drejtor Ekzekutiv*  
*OJQ AKTIV*

## **Përmbajtja**

<b>I. Hyrje</b> .....	<b>4</b>
Çështjet kyçe nga takimi me Kryetarin e Komunës së Shtërpcës.....	4
Çështjet Kyçe nga Takimet me Udhëheqësit Fetarë .....	5
<b>II. Përfundimet dhe Përkushtimet për Veprimet e Ardhshme</b> .....	<b>8</b>
<b>III. Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve</b> .....	<b>12</b>
Z. Dalibor Jevtić, Kryetar i Komunës së Shtërpcës.....	12
Prifti Staniša Milenković, Kisha Ortodokse Serbe në Shtërpcë.....	23
Imam Kujtim ef. Polloviqi, Komuna e Shtërpcës .....	34

## I. Hyrje

Ndalesa e tretë e *Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkekzistencë* ishte komuna jugore e Shtërpçës – e cila e paraqet një qendër turistike të Kosovës. Kjo është një komunë me shumicë serbe, që përbëhet nga një popullatë përafërsisht 60% serbe dhe 40% shqiptare. Takimet ishin ato me Kryetarin e Komunës së Shtërpçës, përfaqësuesin lokal të Kishës Ortodokse Serbe dhe kreun lokal të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Qendrore në këtë ndërmarrje janë “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve,” të cilat janë përpiluar me mprehtësi nga pjesëmarrësit e Karvanit. Këto letra janë më shumë se thjesht një formalitet; këto i mishërojnë shpresat dhe vizionet e singjerta të autorëve të tyre për një të ardhme ku grupet e ndryshme etnike jetojnë së bashku në respekt e paqe. Letrat janë themelore për procesin e dialogut, duke i udhëhequr diskutimet me kryetarët e komunave dhe me udhëheqësit fetarë. Ato përmbajnë sugjerime depërtuese që synojnë përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe rritjen e bashkëjetesës ditore në mesin e komuniteteve.

Para takimeve, të gjithë anëtarët e Karvanit i shkruan këto “Letra të Dëshirave dhe të Pritjeve” për bashkëbiseduesit kryesorë në Shtërpçë: Kryetarin e Komunës Dalibor Jevtić, Priftin e Kishës Ortodokse Serbe, Atin Staniša Milenković, dhe Kreun Lokal të Bashkësisë Islame – Kujtim ef. Polloviqin.

Teksti në vijim i skicon njohuritë kyçe që janë nxjerrë nga këto diskutime të rëndësishme, si dhe letrat që i shprehin aspiratat dhe pritjet e ndara nga anëtarët e Karvanit.

### Çështjet kyçe nga takimi me Kryetarin e Komunës së Shtërpçës

Takimi me Z. Dalibor Jevtićin, Kryetarin e Komunës së Shtërpçës, 11 dhjetor 2024. Përmes letrave të dëshirave dhe të pritjeve, anëtarët e Karvanit shprehën dëshirën e tyre për një rol më të madh të komunës së Shtërpçës në përparimin e multi-etnicitetit dhe të tolerancës, dhe parashtruan për shqyrtim propozime konkrete.

Propozimet kyçe nga letrat e dëshirave dhe të pritjeve që iu adresuan Kryetarit të Komunës:

- **Mbajtja e një Konference Komunale për Dezinformimin:** Që synon adresimin dhe zbutjen e përhapjes së dezinformimit që i ndikon marrëdhëniet ndëretnike brenda komunitetit.
- **Organizimi i Festivaleve Kulturore Multietnike dhe i Ndërmarrjeve Ekonomike:** Propozimet përfshijnë themelimin e festivaleve kulturore që i paraqesin trashëgimitë e ndryshme kulturore të Shtërpçës, së bashku me ndërmarrjet ekonomike të tilla si tregjet e zejtarëve që i promovojnë mjeshtëritë lokale dhe bizneset bashkëpunuese të cilat mund ta rrisin bashkëpunimin midis grupeve të ndryshme etnike.
- **Zhvillimi i Ekipeve Sportive Multietnike dhe i Programeve Edukative:** Nismat për të formuar ekipe sportive që përbëhen nga të rinjtë e prapavijave të ndryshme etnike për ta inkurajuar punën ekipore dhe unitetin. Pos kësaj, programet edukative që përqendrohen në respektimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis fëmijëve mund ta ndihmojnë kultivimin e themelit të miqësive dhe të bashkëpunimit ndëretnik.

- **Promovimi i Turizmit për ta Rritur Ekonominë Lokale:** Shfrytëzimi i peisazheve natyrore dhe i pasurive kulturore të Shtërpcës për t'i tërhequr turistët, duke i përkrahur në këtë mënyrë bizneset lokale dhe duke forcuar një mjedis të komunitetit ku bashkëpunimi ndëretnik jo vetëm që është i domosdoshëm, por është edhe ekonomikisht i levërdishëm.
- **Themelimi i Kretimëve Publike dhe i Ditëve të Diversitetit:** Inkurajimi i organizimit të ngjarjeve që e kretojnë diversitetin etnik të Shtërpcës, përfshirë kretimet publike që i përmbajnë muzikën, ushqimin, dhe artin nga komunitetet e ndryshme, duke e forcuar vlerësimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

Biseda me Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij u përqendrua në përbërjen etnike të komunës, në sfidat ekonomike, dhe në marrëdhëniet ndëretnike brenda komunitetit.

Kryetari i Komunës Jevtić e filloi takimin me një përshkrim të shkurtër të Shtërpcës, duke theksuar vendndodhjen e saj strategjike, pranë tre aeroporteve dhe në afërsi të qyteteve të mëdha si Shkupi, Prizreni dhe Prishtina. Ai përmendi pasurinë e rëndësishme të komunës, Qendrën e Skitarisë Brezovica, dhe potencialin e saj për të nxitur rritje ekonomike. Edhe përkundrejt këtyre përparësive, Jevtići vuri në dukje shkallën e lartë të papunësisë si një sfidë të madhe.

Jevtići vërejti se, nga aspekti i qeverisjes dhe administrimit komunal, serbët dhe shqiptarët lokalë punojnë së bashku mjaft mirë. Mirëpo, ai tregoi se problemet zakonisht dalin nga individët nga jashtë komunitetit, që nuk banojnë në rajon. Ai i ndau shembujt pozitivë të serbëve dhe shqiptarëve lokalë që shpesh herë shoqërohen dhe bëjnë biznes bashkë, gjë kjo e cila, siç beson ai, i zvogëlon konfliktet potenciale.

Diskutimi e pati një kthesë kritike kur Jevtići i shprehu shqetësimet për atë që ndikimet e jashtme janë duke i acaruar tendosjet etnike. Ai argumentoi se këto çështje rëndom përhapen nga njerëzit që nuk jetojnë në Shtërpcë, e cila e komplikon ndërtimin shoqëror lokal.

Biseda preku shkurtimisht çështje më të gjera politike që e ndikojnë Kosovën, me referime të veçanta në zgjedhjet e tashme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës më 9 shkurt 2025. U ngritën shqetësimet për ndikimet potenciale në qeverisjen lokale dhe në marrëdhëniet ndëretnike.

Jevtići theksoi rëndësinë e këshillit të sigurisë të komunitetit komunal, i cili, siç përmendi, takohet rregullisht për t'i adresuar çështjet lokale. Ai nënvizoi atmosferën bashkëpunuese të këtyre takimeve, të cilat përfshijnë përfaqësuesit e prapavijave të ndryshme etnike dhe fetare. Ai i përkrahu në tërësi synimet e *Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë*.

Takimi përfundoi me rikonfirmimin e përkushtimit për ruajtjen dhe rritjen e bashkëpunimit ndëretnik në Shtërpcë. Edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, edhe udhëheqësit komunalë, e shfaqen një perspektivë që shikon përpara, duke u përqendruar në përmirësimet potenciale dhe në promovimin e vazhdueshëm të komunitetit multietnik harmonik.

## Çështjet Kyçe nga Takimet me Udhëheqësit Fetarë

Mesazhet kyçe nga letrat e pritjeve dhe të dëshirave të adresuara për udhëheqësit fetarë ishin të përqendruara përmes vijave të avokimit të mëtutjeshëm të mirëkuptimit dhe bashkekzistencës midis komuniteteve etnike, përfshirë veprimtaritë e përbashkëta, dhe posaçërisht duke pasur parasysh shembullin pozitiv të Pejës. Propozimet kyçe të letrave janë në vijim:

### *Për Kishën Ortodokse Serbe Lokale:*

- **Shkëmbimi Kulturor dhe Edukimi:** Letrat theksojnë rëndësinë e organizimit të ngjarjeve dhe ekspozitave kulturore për ta treguar trashëgiminë e pasur të komunitetit serb. Këto nisma synojnë forcimin e shkëmbimit kulturor dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis grupeve etnike të ndryshme në Kosovë, duke nënvizuar historitë e përbashkëta dhe vlerat kulturore.
- **Kohezioni i Komunitetit përmes Arteve:** Mbajtja e propozuar e ekspozitave artistike që mund të shërbejnë si platforma për artistët e prapavijave të ndryshme etnike për ta shfaqur punën e tyre njëri pranë tjetrit. Ngjarjet e tilla sugjerohen për të promovuar dialogun ndëretnik dhe për të ndërtuar ura brenda komunitetit.
- **Komunikimi dhe Bashkëpunimi i Rritur:** Avokohet për angazhim më sistematik midis Kishës Ortodokse dhe komuniteteve të tjera fetare për ta rritur dialogun ndërfetar. Kjo përfshin takime të rregullta dhe projekte bashkëpunuese që adresojnë çështjet e rëndomta të komunitetit dhe lartësojnë shprehjet kulturore të shumëllojshme.
- **Nismat Edukative:** Sugjerohet zhvillimi i programeve edukative që përqendrohen në historinë dhe kontributet e komunitetit serb në Kosovë. Këto programe synojnë ta edukojnë publikun më të gjerë, dhe posaçërisht rininë, duke forcuar mirëkuptimin dhe respektimin më të madh të diversitetit kulturor.
- **Fushatat e Ndërgjegjësimit Publik:** Rekomandohet nisja e fushatave për ndërgjegjësimin publik që theksojnë shembujt pozitiv të bashkekzistencës dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare në rajon. Këto fushata do t'i shfrytëzojnë rrëfimet dhe shembujt e bashkëpunimeve të suksesshme ndëretnike për të frymëzuar përpjekje të ngjashme anembanë të gjitha komuniteteve.

### Takimi me Atin Staniša Milenković në Kishën Ortodokse Serbe të Shtërpcës, 11 nëntor 2024.

Takimi u mbajt në Kishën Ortodokse të Shtërpcës, ku Ati Milenković e pranoi ngrohtësisht delegacionin, duke i falënderuar për vizitën dhe duke shprehur vlerësimin për nismën e tyre që e synon forcimin e paqes dhe të bashkëjetesës. Dialogu filloi me një përqendrim në kontributin historik, dhe në atë në rrjedhje e sipër, të kishës për komunitetin në Shtërpcë.

Sesioni shpalosi disa çështje kritike që e ndikojnë komunitetin lokal dhe kishën, përfshirë këtu sfidat e drogave dhe të prostitucionit, të cilat Ati Milenković i përshkroi si ndikime të jashtme që paraqesin rreziqe serioze. Ai theksoi se këto çështje kërkojnë angazhim më të gjerë të komunitetit dhe nuk janë të kufizuara në këtë zonë lokale.

Gjatë të tërë takimit, Ati Milenković i nënvizoi sfidat operationale me të cilat përballet kisha, të tilla si përkrahja e pamjaftueshme komunale për shërbimet themelore si mirëmbajtja e rrugëve dhe pastrimi i borës në dimër, të cilat e ndikojnë posaçërisht qasjen në kishë dhe funksionalitetin e saj. Ai vërejti se diskutimet aktuale brenda komitetit të sigurisë në komunitet, në të cilin ai merrte pjesë, i adresojnë këto çështje në mënyrë periodike

Kisha, e themeluar në vitin 1566, qëndron si një pishtar historik në këtë zonë, tha Ati Milenković duke theksuar rëndësinë e saj jo vetëm si vend i adhurimit fetar, por edhe si vend i trashëgimisë kulturore që duhet ruajtur. Ai shprehu shqetësimet për mungesën e një sinjalistike të duhur të trafikut për rrugën për në kishë, e cila i ndikon vizitorët dhe pelegrinët që vijnë në këtë zonë, duke

sugjeruar se një sinjalistikë më e mirë mund ta ndihmojë përmirësimin e qasjes në kishë dhe të vetëdijes për të.

Ati Milenković po ashtu i preku edhe çështjet më të gjera socio-politike, përfshirë edhe implikimet e politikës lokale dhe kombëtare në kohezionin e komunitetit dhe në rolin e kishës në kuadrin e kësaj strukture. Ai e kritikoi shfrytëzimin politik të tendosjeve ndëretnike dhe theksoi neutralitetin e kishës, duke u përqendruar në misonin e saj shpirtëror dhe në shërbimin komunitetit. Lidhur me këtë, ai e përkrahu Karvanin Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Shoqëria civile i diskutoi përpjekjet potenciale bashkëpunuese për t'i adresuar nevojat e veçanta të nënvizuara gjatë takimit, të tilla si përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e shërbimeve sociale.

Në përfundim, takimi nënvizoi rëndësinë e dialogut dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm midis udhëheqësve fetarë dhe shoqërisë civile për ta forcuar bashkëzistencën paqësore dhe për t'i adresuar shqetësimet e ndërsjella në mënyrë efektive. Ati Milenković dhe mysafirët u pajtuan për nevojën për angazhim të vazhdueshëm dhe për përpjekje kolektive për ta siguruar mirëqenien dhe unitetin e komunitetit të Shtërpcës.

#### *Për Komunitetin Lokal Islamik të Kosovës*

- **Nismat Edukative:** Letrat theksojnë nevojën për programet edukative që ushqejnë mirëkuptimin dhe respektimin e ndërsjellë në mesin e të rinjve të komunitetit. Kjo përfshin nisma të edukimit ndërfetar që synojnë t'i zhdukin keqkuptimet dhe të ndërtojnë ura midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare në Shtërpcë.
- **Ngjarjet për Kohezionin e Komunitetit:** Është një shtytje e fuqishme për organizimin e ngjarjeve në komunitet që përfshijnë anëtarët nga të gjitha prapavijat etnike dhe fetare. Këto ngjarje duhet t'i kremtojnë trashëgimitë e ndryshme kulturore dhe ta promovojnë ndjenjën e unitetit dhe të solidaritetit midis banorëve.
- **Përkrahja për Shërbimet Multilinguale:** Është theksuar rëndësia e ofrimit të shërbimeve fetare dhe informatave për komunitetin në më shumë gjuhë ashtu që të akomodohet pamja e shumëllojshme linguistike e rajonit. Kjo mund të ndihmojë për ta përmirësuar komunikimin dhe mirëkuptimin përmes segmenteve të ndryshme të komunitetit.
- **Dialogu Ndërfetar:** Letrat sugjerojnë themelimin e sesioneve të dialogut të rregullt ndërfetar që e inkurajojnë komunikimin e hapur dhe me respekt midis grupeve të ndryshme fetare. Këto dialogje synojnë t'i adresojnë çështjet e komunitetit në mënyrë bashkëpunuese dhe ta thellojnë respektimin e ndërsjellë.
- **Angazhimi i Rinisë:** Është një thirrje për nisma të projektuara në mënyrë të veçantë për t'i angazhuar të rinjtë e prapavijave të ndryshme etnike, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë në zhvillimin e komunitetit dhe në dialogun ndërkulturor. Kjo përfshin ngjarje sportive, tryeza punuese edukative, dhe shkëmbime kulturore që mund ta ushqejnë ndjenjën e komunitetit të përbashkët dhe të bashkëpunimit.

Takimi me Imamin Kujtim ef. Polloviqin e Ferizajit, përgjegjës për Shtërpcën, 23 nëntor 2024. Takimi me Imamin Kujtim ef. Polloviqin u mbajt në fshatin Firajë, afër Shtërpcës. Takimi nënvizoi përkushtimin e përbashkët për ushqimin e harmonisë ndëretnike dhe shpalosi disa njohuri për dinamikën dhe sfidat e komunitetit.

Imami Polloviqi, që është duke shërbyer që nga zgjedhja e tij para katër vitesh, reflektoi për marrëdhëniet ndëretnike brenda komunitetit. Ai vërejt se edhe pse kishte tendosje fillestare të



pas-luftës midis shqiptarëve dhe serbëve, gjatë mandatit të tij nuk kanë ndodhur konflikte përmbajtësore. Banorët jetojnë së bashku në mënyrë paqësore, ku pengesa kryesore për një integrim më të thellë është barriera gjuhësore, meqë anëtarët e komunitetit rëndom nuk i flasin gjuhët e njëri-tjetrit.

Duke marrë pjesë në mënyrë aktive në këshillin komunal për siguri në komunitet, Imam Polloviqi rikujtoi një incident, ku prifti e kishte raportuar një vjedhje në kishë; fajtori ishte gjetur dhe ishte identifikuar si serb që përfshihej në krime të vogla, duke ilustruar që sfidat me të cilat përballen janë rëndom kriminale, dhe jo etnike.

Ai i nënvizoi shërbimet e fuqishme civile në dispozicion në komunë dhe shprehu një botëkuptim pozitiv për përpjekjet për ta ruajtur paqen dhe bashkëjetesën. Edhe përkundrejt këtyre përpjekjeve, kjo zonë përballlet me sfida demografike, ku migrimi i madh është duke zvogëluar popullatën lokale. Në fshatin e tij, tash kanë mbetur vetëm 60 shtëpi, në vendin që më parë i kishte pasur 300 shtëpi. Rënia pasqyrohet në shkollën e mesme lokale, e cila tash i ka vetëm 90 nxënës nga zona përreth, duke treguar në këtë mënyrë një trend më të gjerë të migrimit drejt qyteteve më të mëdha apo jashtë vendit.

Për më tepër, Imami e tërhoqi vëmendjen për gjendjen e rëndë të xhamisë më të vjetër të rajonit, që daton që nga shekulli 17, dhe e cila ishte në rrezik të shembjes për shkak të fondeve të pamjaftueshme për restaurimin e domosdoshëm. Kjo xhami, që është një pjesë kyçe e strukturës historike dhe kulturore të rajonit, ka nevojë për një përkrahje urgjente për ta ruajtur strukturën dhe trashëgiminë e vet.

Takimi përfundoi me një përkushtim të përforcuar, si nga pjesëtarët e shoqërisë civile, ashtu edhe nga Imam Polloviqi, për t'i vazhduar përpjekjet bashkëpunuese për ta promovuar dialogun ndëretnik dhe kohezionin e komunitetit. Vizita jo vetëm që nënvizoi gjendjen aktuale të paqes, por po ashtu edhe nevojat aktuale dhe fushat potenciale për bashkëpunim të mëtutjeshëm për ta siguruar stabilitetin dhe rritjen e këtij komuniteti multi-etnik.

## II. Përfundimet dhe Përkushtimet për Veprimet e Ardhshme

Takimet që u mbajtën në nëntor dhe dhjetor 2024 dhanë njohuri jashtëzakonisht të vlefshme për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërfetare në komunë. Këto angazhime shpалosën, edhe përparimin mjaft të madh që është bërë, edhe sfidat që vazhdojnë të këmbëngulin, duke e theksuar nevojën për bashkëpunim të mëtutjeshëm bazuar në themelin ekzistues, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së tij, përfshirë edhe nevojën për maksimalizimin e potencialit turistik të komunës, në bashkëpunim dhe konsultim të plotë me komunitetin lokal dhe institucionet komunale.

### **Përfundimet**

#### **1. Kohezioni Ndëretnik:**

- Shtërpcja demonstroi një harmoni relative ndëretnike edhe përkundrejt tendosjeve historike, ku udhëheqësit lokalë e luajnë rolin kryesor në ruajtjen e bashkëjetesës paqësore.
- Sfidat kryesore burojnë më shumë nga ndikimet e jashtme dhe çështjet më të gjera socio-politike sesa nga vetë komuniteti.

## **2. Rënia Demografike:**

- Një rënie domethënëse e popullatës për shkak të migrimit është duke e ndikuar vitalitetin e komunitetit, duke e reduktuar vijueshmërinë e shkollave dhe numrin e ekonomive familjare aktive.

## **3. Trashëgimia Kulturore në Rrezik:**

- Objektet fetare historike të rajonit, përfshirë Xhaminë e shekullit 17 dhe Kishën Ortodokse, përballen me sfida strukturale dhe operacionale që kërkojnë përkrahje dhe mbrojtje të menjëhershme.

## **4. Angazhimi Rinor dhe Shumëgjuhësia:**

- Është një mungesë e nismave të mjaftueshme për ta angazhuar rininë dhe për ta adresuar pengesën e gjuhës që e frenon një integrim më të thellë ndëretnik.

## **5. Infrastruktura dhe Çështjet Ekonomike:**

- Infrastruktura e varfër dhe papunësia e lartë këmbëngulin, duke e penguar potencialin e komunës edhe përkundrejt afërsisë së saj me qytetet kryesore dhe pasurive turistike si Qendra e Skitarisë Brezovica.

## **6. Mbrojtja dhe Siguria e Komunitetit:**

- Këshillat lokale të sigurisë së komunitetit, përfshirë edhe përfaqësuesit fetarë dhe të shoqërisë civile, janë vendimtarë për adresimin e veprimtarive kriminale si dhe për promovimin e sigurisë së komunitetit.

### ***Plani për Veprimet e Ardhshme***

Këto përkushtime e rikonfirmojnë zotimin kolektiv për t'i çuar përpara marrëdhëniet aktuale pozitive në Shtërpcë, duke e bërë këtë po ashtu model që në të ardhmen duhet të ndiqet nga komunat e tjera dhe potencialisht edhe nga qeveria qendrore. Duke u përqendruar në dialog, përfshirje dhe përparim të përbashkët, takimet rezultuan me përkushtimet në vijim.

#### **1. Nismat Edukative dhe Angazhimi i Rinisë**

- Zhvillimi i programeve edukative ndërfaqetare dhe ndëretnike për shkolla me qëllim të promovimit të mirëkuptimit dhe respektimit të ndërsjellë në mesin e fëmijëve.
- Organizimi i aktiviteteve të orientuara kah rinia, të tilla si ekipet sportive, shkëmbimet kulturore dhe tryezat punuese edukative për t'i forcuar miqësitë përmes vijave etnike.

#### **2. Ngjarjet për Kohezionin e Komunitetit**

- Mikpritja e festivaleve kulturore multietnike, e ditëve të diversitetit, dhe kremtimet publike që e tregojnë trashëgiminë e pasur kulturore të rajonit, për t'i forcuar lidhjet ndëretnike.
- Inkurajimi i grumbullimeve të komunitetit dhe përvojat e përbashkëta kulturore për ta kremtuar diversitetin dhe unitetin.

#### **3. Infrastruktura dhe Zhvillimi Ekonomik**

- Avokimi për financimin e restaurimit të xhamisë historike dhe të infrastrukturës përreth Kishës Ortodokse, duke siguruar ruajtjen e këtyre pikave kulturore dhe fetare të referimit.
- Forcimi i turizmit përmes sinjalistikës më të mirë të trafikut, infrastrukturës së përmirësuar, dhe fushatave për promovimin e bukurive natyrore dhe të vendeve me rëndësi historike të rajonit.
- Promovimi i bashkëpunimit ekonomik përmes tregjeve të zejtarëve dhe bizneseve bashkëpunuese që i përfshijnë të gjitha grupet etnike.

#### **4. Përpjekjet Multilinguale dhe Ndërfetare**

- Përkrahja e jetësimit të shërbimeve multilinguale në institucionet publike dhe fetare për t'i tejkalluar pengesat gjuhësore.
- Vendosja e sesioneve të dialogut të rregullt ndërfetar për t'i adresuar sfidat e përbashkëta dhe për ta ushqyer respektimin e ndërsjellë.

#### **5. Trajtimi i Çështjeve më të Gjera Sociale**

- Puna me hisenikët lokalë dhe të jashtëm për t'i luftuar sfidat e tilla si drogat, prostitucioni, dhe dezinformimi, përmes fushatave për ndërgjegjësimin e publikut dhe angazhimit më të fuqishëm të komunitetit.
- Organizimi dhe mikpritja e një konference komunale për dezinformimin për t'i adresuar ndikimet e jashtme që i acarojnë tendosjet etnike.

#### **6. Bashkëpunimi i Vazhdueshëm**

- Forcimi i rolit të këshillave komunal për siguri duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive nga udhëheqësit e ndryshëm të komunitetit dhe duke u përqendruar në zgjidhjen e lokalizuar të problemeve.
- Forcimi i një angazhimi më të thellë midis shoqërisë civile, udhëheqësve fetarë, dhe autoriteteve komunale për rritjen dhe stabilitetin afatgjatë të komunitetit.

Takimet në Shtërpçë:  
Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësit Fetarë



Z. Dalibor Jevtić,  
Kryetari i Komunës së Shtërpçës,  
5 dhjetor, 2024



Takimi me Atin Staniša Milenković në Kishën  
Ortodokse Serbe të Shtërpçës,  
5 dhjetor, 2024



Takimi me Imamin Kujtim ef. Polloviqi të  
Ferizajit, përgjegjës për Shtërpçën,  
23 nëntor, 2024



## Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Jovana Radosavljević, Ramadan Ilazi, Dušan Radaković, Ilir Deda,  
Senad Šabović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Z. Dalibor Jevtić, Kryetar i Komunës  
Komuna e Shtërpcës

Dhjetor 2024

**Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive**  
**New Social Initiative**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri z. Jevtić,

Jam duke ju shkruar lidhur me situatën gjithnjë e më sfiduese me të cilën përballet komuniteti serb në Kosovë, duke e theksuar rëndësinë e veprimit kolektiv dhe domosdoshmërinë e unitetit për t'i adresuar në mënyrë efektive çështjet emergjente para nesh.

Komuniteti serb i Kosovës vazhdon të përballet me vështirësi të shumta, përfshirë pasigurinë, qasjen e kufizuar në të drejtat themelore, dhe sfidat socio-ekonomike që i kërcënojnë jetët e tyre të përditshme. Këto rrethana thërrasin për hapa vendimtarë për ta siguruar një të ardhme paqësore, stabile dhe dinjitoze. Në këtë kontekst, mbajtja e unitetit përbrenda komunitetit tonë është vendimtare për mbrojtjen dhe avancimin e interesave tona të përbashkëta.

Njësoj i rëndësishëm është edhe forcimi i bashkëpunimit dhe bashkekzistencës ndëretnike anembanë Kosovës. Ndërtimi i besimit dhe krijimi i hapësirës për dialog midis komuniteteve nuk është vetëm një domosdo morale por është po ashtu edhe një parakusht për stabilitet dhe siguri afatgjate. Përgjegjësi jona e përbashkët është të avokohet për tolerancë dhe respektim të ndërsjellë, duke i kontribuar një të ardhmeje nga e cila përfiton jo vetëm komuniteti serb, por edhe të gjithë qytetarët e Kosovës.

Pozita juaj si Kryetar i Komunës së Shtërpcës ua jep mundësinë për t'i jetësuar nismat dhe projektet konkrete që mund ta përhapin ndryshimin pozitiv përbrenda komunitetit serb të Kosovës dhe strukturës më të gjerë shoqërore. Përmes përpjekjeve të përbashkëta, ne mund t'i shtrojmë themelet për një të ardhme më stabile dhe më të sigurtë, duke siguruar mbrojtjen dhe zhvillimin e komunitetit tonë ndërkohë që e forcojmë mirëkuptimin e ndërsjellë me të tjerët.

Sinqerisht

Jovana Radosavljević

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri z. Jevtić,

Si Kryetar i Komunës së Shtërpçës, ju e keni një përgjegjësi të madhe për promovimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndëretnik. Unë jam duke ju shkruar për ta shprehur interesimin tim për t'ju përkrahur në nismat tuaja që e synojnë forcimin e bashkëpunimit ndëretnik dhe përmirësimin e normave demokratike në Kosovë.

Ju tashmë i keni ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. Për shembull, Forumet e Komunitetit për Interesat Publike (CFPI – Community Forums for Public Interests), që janë mbajtur në komunë tuaj, e kanë treguar përkushtimin tuaj për promovimin e bashkëpunimit ndëretnik krahas interesave të përbashkëta.

Duke pasur parasysh diversitetin e pasur kulturor të komunës suaj, Shtërpçja e ka një potencial unik për të shërbyer si një model i bashkekzistencës dhe respektimit të ndërsjellë. Për këtë qëllim, ju propozoj të punoni për t'i forcuar Komitetet Komunale për Komunitete, të organizoni takime më të rregullta dhe publike të këtij mekanizmi, dhe ta transformoni këtë forum institucional si një institucion udhëheqës komunal në promovimin e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Së dyti, unë dezinformimin e shoh si një kërcënim dhe brengë kryesore për marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, dhe dëshiroj të propozoj që Komuna e Shtërpçës të organizojë një konferencë komunale që i kushtohet kuptimit më të mirë të asaj se si kjo është duke e ndikuar cilësinë e bashkëpunimit ndëretnik në komunë. Po ashtu, do të doja të sugjeroj që zyres për komunikim me publikun t'i kërkonti t'i kushtojë më shumë vëmendje kësaj dukurie.

Do të isha i lumtur t'i diskutoj këto ide më tutje me ju, dhe të shikojmë se si mund t'i përshtatim këto së bashku me prioritetet e komunës. Udhëheqësia juaj është kyçe për të siguruar që këto nisma do të kenë sukses, dhe pres mundësinë të punojmë së bashku për ta ndërtuar një komunë më të fuqishme dhe më kohezive në Shtërpçë.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj. Ju lutem të ndjeheni të lirë të më kontaktoni sapo të jetë e përshtatshme për ju për ta caktuar një takim.

Sinqerisht,

Ramadan Ilazi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv**  
**Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Kryetar i Komunës, Dalibor Jevtić,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë në shëndet e disponim të mirë. Quhem Dušan Radaković, dhe shërbej si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Avokimin e Kulturës Demokratike (ACDC – Advocacy Center for Democratic Culture) në Mitrovicë. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një nismë kjo që synon promovimin e dialogut dhe mirëkuptimit ndëretnik anembanë Kosovës. Udhëheqësia juaj në Shtërpcë, një komunë kjo që njihet për karakterin dhe trashëgiminë e vet multi-etnike, juve ju bën një partner thelbësor në udhëtimin tonë kolektiv drejt forcimit të unitetit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme të Kosovës.

Si Kryetar i Komunës së Shtërpcës, roli juaj është thelbësor në sigurimin që të gjithë qytetarët të ndjehen të përfshirë dhe të përfaqësuar. Peisazhi i shumëllojshëm kulturor i Shtërpcës dhe historia e saj e ofrojnë një mundësi unike që të udhëhiqet përmes shembullit në promovimin e bashkëjetesës paqësore.

- Si planifikoni t'i forconi më tutje marrëdhëniet ndëretnike midis komuniteteve serbe dhe shqiptare në Shtërpcë?
- Çfarë masash mund të ndërmerr administrata juaj për t'i nxitur hapësirat e përbashkëta të komuniteteve, shkëmbimet kulturore, apo ndërmarrjet e përbashkëta ekonomike, që forcojnë besimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.
- A mund t'i ndani kuptimet tuaja për atë se si politikat administrative të Shtërpcës i kanë kontribuar me sukses dialogut ndëretnik, dhe çfarë përmirësimesh mund të bëhen?

Unë parashoh që Shtërpcja do të bëhet një komunë model për bashkëjetesën paqësore dhe harmonike në Kosovë. Për ta arritur këtë, është kritike që t'u jipet parësi strategjive afatgjata që e promovojnë mirëkuptimin, bashkëpunimin, dhe respektimin e ndërsjellë midis grupeve etnike.

- Çfarë është vizioni juaj për komunën nga këndvështrimi i krijimit të një mjedisi ku të gjitha komunitetet mund të lulëzojnë së bashku?
- A shihni potencial për nismat e përqendruara kah rinia që i bëjnë bashkë serbët, shqiptarët, dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, përmes edukimit, sporteve, dhe veprimtarive kulturore?
- A mundet Shtërpcja të shërbejë si një qendër për bashkëpunimet ndër-komunale të interesave të përbashkëta, të tilla si turizmi, bujqësia, dhe qendrueshmëria mjedisore, duke i bashkuar në këtë mënyrë grupet e ndryshme rreth qëllimeve të përbashkëta?

Ju inkurajoj ta shqyrtoni mikpritjen e forumeve apo ngjarjeve ndër-etnike në Shtërpcë, që u mundësojnë banorëve t'i ndajnë përvojat, sfidat dhe aspiratat e tyre. Kjo mund të përfshijë:

Festivale të përbashkëta kulturore që i kremtojnë traditat e të gjitha komuniteteve.

Diskutime në tryeza të rrumbullakëta me udhëheqës lokalë, me organizata të shoqërisë civile, dhe me banorët, për t'i identifikuar dhe adresuar pengesat për bashkëjetesë.

A do të ishte e hapur administrata juaj për të bashkëpunuar për nisma të tilla?



Z. Jevtić, ju falemnderit për shqyrtimin e kësaj letre. Përkushtimi juaj i vazhdueshëm për përmirësimin e jetëve të të gjithë qytetarëve në Shtërpcë është jetik për suksesin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë. Shpresoj të angazhohemi në diskutime konstruktive me ju dhe ekipin tuaj, duke synuar të krijojmë hapa konkret drejt një të ardhmeje paqësore dhe përfshirëse.

Përshëndetje të përzemërta,

Dušan Radaković

**Ilir Deda, Aktivist i Shoqërisë Civile  
Prishtinë, Kosovë**

I Dashuri Kryetar i Komunës Jevtić,

Ashtu siç e dini, për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e bashkëjetesës multietnike dhe multifetare në Shtërpcë, si një zonë tejet e suksesshme multietnike dhe multifetare. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash, kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Ju keni lëvizur nëpër kohë tejet të vështira, dhe pavarësisht nga pengesat e keni ruajtur një mirëkuptim të madh me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Shtërpcë, përfshirë këtu edhe përfaqësimin dhe investimin.

Shtërpcja është e paracaktuar me karakterin e vet multietnik, si dhe me atë që është një lokacion i rëndësishëm qendror turistik në Kosovë. Këtu unë jam shumë i interesuar të dëgjoj nga ju se çfarë ne si anëtarë të këtij Karvani mund të bëjmë për ta ndihmuar komunën e Shtërpcës për ta maksimalizuar potencialin e vet turistik.

Jam duke pritur që me ju t'i shqyrtoj idetë në vazhdim:

1. Projektet rinore multietnike të cilat mund të zhvillohen me komunën;
2. Ekipet sportive multietnike që mund të themelohen nën udhëheqjen tuaj;
3. Një ditë komunale për kremtimin e diversitetit të Shtërpcës;
4. Një forum për dialogun ndërfaqësor i cili mund të krijohet me asistencën komunale.

Besoj se puna juaj dhe qëndrimi respektues mund të na ndihmojnë në ndërtimin e një modeli të suksesshëm për bashkekzistencën anembanë Kosovës.

Meqë ju keni qenë një Kryetar shumë i respektuar i Komunës nga të dyja komunitetet etnike në komunën e Shtërpcës, është jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptojmë nëse ka hapa shtesë që ne mund t'i ndërmarrim për ta përkrahur punën tuaj.

Une besoj fuqishëm që udhëheqësia juaj në këtë pikë është kritike për ruajtjen e marrëdhënieve të mira ndëretnike në Kosovë, dhe shpreh shpresën time që ju do t'i merrni parasysh veprimet e propozuara.

Me përshëndetjet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë  
Instituti Evropian për Paqe  
Bruksel - Prishtinë**

I nderuari Kryetar i Komunës Jevtić,

Gjatë viteve kam pasur kënaqësinë të punoj me Ju në angazhime të shumta të rëndësishme. Siç e dini, unë tash punoj si Këshilltar i Lartë në Institutin Evropian të Paqes, me përqendrim parësor në përkrahjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile të quajtur Alternative Qytetare e Kosovës (KCA – Kosovo Civic Alternative), e cila përpiket ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë. Unë jam po ashtu anëtar i projektit të quajtur *Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë* dhe jam duke ju shkruar në këtë cilësi.

Është në përcaktimin e projektit që ne t'u shkruajmë nga një letër të pritjeve bashkëbiseduesve të respektuar që i takojmë në komunat e përfshira. Prandaj kjo letër don t'i shpreh pritjet e mia nga Ju sa i përket multi-etnicitetit dhe bashkëjetesës. Në qasjen tonë, ne jemi të shtyrë nga parimet e multi-etnicitetit që janë të rrënjësura fuqishëm në sistemin kushtetues dhe legal të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë pritjet kyçe të bashkësisë ndërkombëtare sa i përket Kosovës. Në çastin e tashëm, këto vlera nuk mbështeten detyrimisht nga të gjithë aktorët në Kosovë, por ka shumë prej tyre – politikë, media, dhe nga spektri i shoqërisë civile – që vazhdojnë të besojnë në këto vlera dhe janë duke punuar për ta fuqizuar jetësimin e tyre. Ata që i çmojnë ato kanë nevojë për partnerë, ashtu që së bashku ta dëshmojnë se multi-etniciteti funksionon dhe se është dhe do të mbetet këtu.

Gjatë viteve, mua më ka lënë një përshtypje të fuqishme kontributi juaj për multi-etnicitetin funksional në Kosovë. Ju i keni udhëhequr apo keni kontribuar në disa nga kornizat kyçe lidhur me këtë. Përkushtimi juaj, që është i barabartë me qasjen tuaj praktike dhe besimin që e ndërtoni me të gjithë hisenikët, janë vërtetë shembullorë. Tash, unë e kuptoj që si kryetar i një komune me shumicë serbe ju nuk ndjeheni detyrimisht të fuqizuar për të nisur angazhime të këtij lloji. Kjo është e kuptueshme, dhe posaçërisht në rrethanat e tashme të marrëdhënies të tendosura ndër-etnike dhe të procesit të ngujuar të normalizimit. Komuniteti serb, dhe jo vetëm në Veri, është i brengosur me arsye dhe do të shikojë në udhëheqësit e vet politikë për reagime. Prandaj, nëse ka ndonjë hapje për t'i përmbysur trendet aktuale negative apo për t'u përgjigjur çfarëdo nismave të sinqerta multi-etnike që vijnë nga spektri shoqëror-politik i Kosovës i rrymës së përgjithshme, intervenimi juaj do të ishte më i efektshmi. Ata që nuk e mbështesin multi-etnicitetin në Kosovë janë pikërisht ata që përfitojnë nga dështrimi i nismave të tilla nga ana e atyre që dëshirojnë ta mbështesin atë.

Grupi i projektit tonë kohëve të fundit e ka zhvilluar një varg takimesh në komunat e tjera, përfshirë me Kryetarët e Komunave dhe udhëheqësit fetarë, dhe ne vërtetë kemi parë shumë vullnet të mirë në këtë nivel ndaj nismave multi-etnike. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka qenë shumë i hapur në takimin tonë, ndërkaq, ka qenë një kënaqësi e posaçme për ta takuar Kryetarin e Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxherin, që është një shembull madhor lidhur me këtë. Për shembull, ai e ka vendosur një ditë zyrtare të tolerancës ndër-etnike që kremtohet në bazë vjetore me financimin e komunës.

Bazuar në të gjitha këto që u thanë më sipër, mbase mund të ketë mundësi për ndonjë formë të veprimtari ndër-komunal në fushën e multi-etnicitetit. Ne po ashtu kemi qenë dëshmitarë të asaj që edhe komunitetet fetare do të bashkangjiteshin në këtë. Në dritën e kësaj të tërës, kolegët nga projekti dhe unë do të donim t'ju inkurajojmë që t'u përgjigjeni këtyre nismave dhe t'i ofroni edhe vetë disa sugjerime – dhe madje edhe të ndërmerrni të tilla kur të ndjeni se janë me vend. Nga

aspekti i përgjithshëm, shfrytëzimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multi-etnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë deklarata për shtyp apo përmbajtjet në mediat sociale nga Ju dhe komuna në gjuhët e komuniteteve, për shembull në rastin e ditëve të tyre kombëtare apo në festat e tyre fetare. Kjo mund të përfshijë po ashtu edhe vizita të publikuara së bashku me kryetarët e komunave përreth në qendrat e komuniteteve apo të fqinjërive multietnike, duke e inkurajuar bashkëjetesën paqësore dhe multietnicitetin. Janë këto aspektet ku Ju jeni po ashtu një shembull i shkëlqyer dhe këto rrëfime kanë nevojë të jenë më të dukshme anembanë Kosovës.

Më në veçanti, mund të ndërmerret një nismë për projektet e përbashkëta ndër-komunale me komunat e tjera, qoftë në rajonin tuaj, ose edhe më gjerë. Kjo do të ishte një mënyrë shumë e mirë për t'u angazhuar në ndërtim të besimit të orientuar kah zhvillimi. Kjo mund të zhvillohet në një strukturë të qëndrueshme ndërkomunale të bashkëpunimit që atëherë mund të angazhohet me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe mbase edhe me forma të tjera të asociemeve komunale në projektet që e pasqyrojnë këtë koncept të njëjtë.

I nderuari Kryetar i Komunës, jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i KCA-së, do të jenë të gatshëm që me kënaqësi t'ju ofrojnë përkrahje konkrete për zbatimin e sugjerimeve të dhëna këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Šabović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë  
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Prishtinë, Kosovë**

I Nderuari Kryetar i Komunës, z. Dalibor Jevtić,

Quhem Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe Ligjerues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003–2016 kam qenë po ashtu edhe ligjerues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër jam duke ju shkruar për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndër-etnike në Kosovë.

Para së gjithash, shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë në shëndet e disponim të mirë. Këtë jam duke ua shkruar në emrin tim dhe të KIPRED-it, si dhe të disa organizatave të tjera me të cilat e kemi të përbashkët përkushtimin për forcimin e mirëkuptimit dhe të respektimit të ndërsjellë midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, më përgjithësisht, dhe në komunën e Shtërpçës në veçanti.

Ne jemi të vetëdijshëm shumë mirë se në periudha të ndryshme historia jonë e përbashkët është shënuar nga tendosje dhe konflikte; por ajo është shënuar po ashtu edhe me periudha të bashkëjetesës dhe të bashkëpunimit paqësor, dhe, në të dyja komunitetet, kjo histori jona ka qenë po ashtu e pasuruar nga trashëgimi të thella kulturore dhe shpirtërore. Është bindje imja e fuqishme që përmes vullnetit të mirë dhe bashkëpunimit ne mund ta hapim rrugën drejt një të ardhmeje ku komunitetet tona do të bashkekzistojnë në harmoni, duke punuar së bashku për të mirën e përbashkët.

Qëllimi i përbashkët i koalicionit tonë të OJQ-ve është ta krijojmë një mjedis më përfshirës, me më shumë mirëkuptim, dhe më paqësor për të gjithë qytetarët tonë. Ne jemi të bindur se duke punuar së bashku – qeveritë lokale, udhëheqësit fetarë, shoqëria civile dhe udhëheqësit komunalë – ne mund të nisim veprime domethënëse që mund t'i tejkalojnë ndasitë dhe t'i forcojnë marrëdhëniet tona ndëretnike.

Për këtë qëllim do të doja t'i propozoj disa nisma provuese që do të mund t'i ndërmirrin OJQ-të tona në bashkëpunim me Komunën (kuptohet, pa u kufizuar vetëm në to – gjatë këtij procesi ne mund të gjejmë edhe të tjera):

1. **Programe të përbashkëta kulturore dhe edukative**, të tilla si festivale, tryeza të rrumbullakëta, ture historike, që e theksojnë trashëgiminë tonë të përbashkët kulturore dhe që e promovojnë respektimin e ndërsjellë.
2. **Projektet për ndërtimin e komunitetit**, ku shqiptarët dhe serbët do të merrnin pjesë në aktivitete si përmirësimet e hapësirave publike, pastrimet e lagjeve, apo nismat humanitare që i adresojnë nevojat e përbashkëta të të gjithë qytetarëve.
3. **Angazhimet e rinisë dhe nismat për dialog**, përfshirë ngjarjet sportive, bashkëpunimet artistike dhe forumet e dialogjeve, të përpiluara për t'i fuqizuar të rinjtë e të dyja komuniteteve për të punuar së bashku për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme. Për shembull, një aktivitet i tillë mund të jetë shfrytëzimi i mundësive turistike të rrethit të Shtërpçës për organizimin e tryezave të rrumbullakëta ku të rinjtë shqiptarë dhe serbë do të diskutonin mundësitë që një numër i tyre ta fillonin mësimin e gjuhëve amëtare të njëri-tjetrit.

Platformat për dialog gjithsesi do t'u mundësojnë banorëve të prapavijave të ndryshme që t'i japin këndvështrimet dhe idetë e tyre. Kjo nismë jo vetëm që do t'i fuqizonte individët, por po ashtu do ta forcojë besimin dhe bashkëpunimin midis grupeve etnike.

Ne jemi të bindur që Komuna e Shtërpcës mund ta luaj një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në këto nisma, duke ofruar përkrahje, duke e ndihmuar dialogun, dhe duke i mbështetur projektet që e nxisin bashkekzistencën paqësore. Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë ngushtë me zyren tuaj dhe institucionet e tjera lokale për t'i zhvilluar dhe jetësuar këto ide.

Unë do të jem i lumtur që ta kem mundësinë të takohem me ju dhe ekipin tuaj për t'i diskutuar më tutje këto propozime dhe për të shikuar si mund të punojmë së bashku për të mirën e të gjithë banorëve të Shtërpcës. Ne mbesim me shpresë që këto përpjekje do t'i kontribuojnë një të ardhmeje më të bashkuar dhe më harmonike për komunën tonë.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj. Pres përgjigjen tuaj dhe mundësinë për të punuar bashkë për të mirën e komuniteteve tona.

Me respekt të thellë dhe përshëndetjet më të sinqerta,

Mentor Agani,

**Zoran Savić, Koordinator i Projekteve**  
**NGO AKTIV**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Dalibor Jevtić,

Quhem Zoran Savić dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut. Edhe pse i lindur në Pulë të Kroacisë, unë në fakt kam jetuar në Mitrovicë për 30 vjet dhe jam i përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore në Kosovë, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, meqë jam po ashtu edhe muzikant, dhe kam marrë pjesë në projekte të ndryshme ndër-etnike me muzikantë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite me radhë kam punuar si gazetar në portalin Kosovo Sever, KosSev, dhe përmes kësaj pune jam bërë edhe më i afërt me situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Pozita juaj si Kryetar i Komunës së Shtërpçës mund të ndihmojë shumë në promovimin e mesazheve të paqes dhe të unitetit. Prandaj pres përkrahjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndëretnike dhe të projekteve për shërbimin e komunitetit që përfshijnë grupe të ndryshme etnike duke punuar së bashku.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multi-etnike në Kosovë do të shndërrohet në normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet etnike përvetësohen si fuqi, jo si burime të ndarjeve. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet dhe tolerancë kulturore, në përkrahjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit.

Prandaj, ju nxis që të merrni pjesë në mënyrë aktive në krijimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës, duke përkrahur nismat ndër-etnike, duke avokuar për politika që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë.

Këtë letër po e përfundoj me një shënim shpresëdhënës, duke e paraparë një të ardhme ku përpjekjet tona të përbashkëta do ta kultivojnë një shoqëri mirëfilli harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të vlefshëm.

Zoran Savić



## Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Jovana Radosavljević, Ramadan Ilazi, Dušan Radaković, Ilir Deda,  
Senad Šabović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Prifti Staniša Milenković, famullitar i Prizrenit  
Kisha Ortodokse Serbe në Shtërpcë

Dhjetor 2024



**Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive**  
**New Social Initiative**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri At Staniša,

Jam duke ju shkruar me një respekt dhe vlerësim të thellë për punën e palodhshme të Kishës Ortodokse Serbe, e cila vazhdon të shërbejë si një dritë udhëndriçuese për komunitetin serb në Kosovë, duke e ofruar fuqinë shpirtërore, ruajtjen kulturore dhe udhëheqjen morale në këto kohë sfiduese.

Komuniteti serb në Kosovë përballet me vështirësi të shumta, nga kërcënimet për trashëgiminë e tij kulturore dhe fetare, e deri te lufta e përditshme për ta ruajtur identitetin dhe për t'i siguruar të drejtat themelore. Në rrethana të tilla, Kisha mbetet një shtyllë e qëndrueshme e shpresës, unitetit, dhe qëndrueshmërisë. Misioni i saj shekullor i promovimit të paqes dhe pajtimit, si dhe besimi, kanë qenë instrumentale në të ndihmuarit e njerëzve për t'u orientuar përmes fatkeqësive.

Në këtë ndërmarrje, roli juaj si Vikar i Prizrenit mbart një domethënie shumë të madhe. Përmes përkushtimit tuaj, Kisha shërben jo vetëm si vend i adhurimit, por po ashtu edhe si një strehë e shenjtë e përkrahjes dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, ku ushqehen vlerat e unitetit, të tolerancës dhe të bashkekzistencës. Ky rol është jetik jo vetëm për komunitetin tonë por po ashtu edhe për forcimin e dialogut dhe besimit ndëretnik midis popujve të Kosovës.

Mbrojtja afatgjatë e bashkekzistencës paqësore nga ana e Kishës dhe theksimi i saj i rëndësisë së vlerave të përbashkëta njerëzore kanë qenë gjithmonë një burim i frymëzimit. Në këto përpjekje, besoj se është një potencial i madh për t'i forcuar edhe më tutje lidhjet përbrenda komunitetit serb të Kosovës dhe për të ndërtuar ura me komunitetet e tjera, duke e forcuar ndjenjën e respektimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë në atdheun tonë të përbashkët.

Me respektim dhe falënderim të përzemërt

Jovana Radosavljević

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Prift Milenković,

Shpresoj që ky mesazh do t'ju gjejë mirë. Si udhëheqës shpirtëror i komunitetit të krishterë ortodoks të Prizrenit, roli juaj në promovimin e paqes dhe të mirëkuptimit është i pamatshëm, dhe posaçërisht në këto kohë kur forcimi i bashkëpunimit ndërfaqetarak dhe ndëretnik është aq jetik për rajonin.

Jam duke ju drejtuar për ta shprehur respektin e thellë për punën tuaj dhe për t'i propozuar disa ide për ta përparuar pajtimin dhe respektimin e ndërsjellë midis të gjitha komuniteteve të Kosovës. Më në veçanti, unë besoj se ne mund të punojmë së bashku në promovimin e dialogut ndërfaqetarak. Për këtë qëllim, do të sugjeroja që organizatat e shoqërisë civile, të tilla si KIPRED-i dhe AKTIV-i, apo edhe think-tanku në të cilin punoj, KCSS, t'ju presim juve dhe udhëheqësve të tjerë fetarak për një ngjarje publike ndërfaqetarak.

Po ashtu, do të doja t'ju inkurajoj që ta organizoni ndonjë ngjarje që e promovon ruajtjen kulturore, duke u përqendruar në trashëgiminë e përbashkt të Komunës së Prizrenit.

Udhëheqja dhe përkushtimi juaj për këto kauza mund ta rrisin në një masë të madhe ndikimin e këtyre përpjekjeve.

Ju faleminderit për përkushtimin tuaj të palodhshëm për komunitetin tuaj, dhe pres të njoftohem me mendimet tuaja për këtë bashkëpunim potencial.

Me respektin më të thellë,

Ramadan Ilazi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv  
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)  
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri At, Staniša Milenković,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Quhem Dušan Radaković, dhe shërbej si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC – Advocacy Center for Democratic Culture) në Mitrovicë. Jam duke ju drejtuar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një nismë kjo që synon forcimin e unitetit dhe mirëkuptimit midis komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Si Vikar i Prizrenit dhe si udhëheqës shpirtëror brenda Kishës Ortodokse Sebe, zëri juaj është i paçmueshëm për promovimin e parimeve të tolerancës, të respektimit dhe të përkrahjes së ndërsjellë.

Udhëheqësit fetarë e luajnë një rol kritik në trajtësimin e qëndrimeve dhe në forcimin e pajtimit. Si Vikar i Prizrenit, qasja juaj te komunitetet serbe, por edhe shqiptare, mund të ndihmojë në ndërtimin e urave dhe në zhdukjen e paragjytimeve.

- Çfarë janë pikëpamjet tuaja për atë se si besimi dhe feja mund të shërbejnë si mjete për ta forcuar pajtimin dhe për ta promovuar mirëkuptimin ndëretnik në Prizren?
- A mundet Kisha Ortodokse Serbe në Prizren të nisë përpjekje të përbashkëta me organizatat e tjera të bazuara në besim për të nxitur dialogun dhe bashkëpunimin midis komuniteteve?
- Si do të mund t'i përkrahte kisha aktivitetet multi-etnike, dhe posaçërisht ato për rininë, për ta mundësuar një gjeneratë të re të bashkëpunimit dhe besimit?

Unë e parashoh një të ardhme ku Prizreni shërben si flakadan i harmonisë dhe i bashkëpunimit, duke e krenuar diversitetin e vet të pasur kulturor dhe fetar. Udhëheqja juaj mund të ndihmojë për t'i shtruar themelet për një të ardhme të tillë duke e inkurajuar bashkëpunimin midis komuniteteve të besimit dhe duke i përkrahur nismat që i bëjnë bashkë grupet e ndryshme.

- A mund të organizojë Kisha ngjarje kulturore apo fetare në partneritet me institucionet e tjera fetare për ta krenuar trashëgiminë e të gjithë banorëve të Prizrenit?
- A ka mundësi të ringjallen praktikat tradicionale të bashkekzistencës dhe të respektimit të ndërsjellë që historikisht e kanë karakterizuar Prizrenin?
- Çfarë roli besoni se mund të luaj Kisha në adresimin e ndarjeve këmbëngulëse midis komuniteteve në Kosovë?

Ju inkurajoj ta merrni parasysh angazhimin me udhëheqësit lokalë, me organizatat e shoqërisë civile, dhe me grupet e rinisë, për ta forcuar mirëkuptimin ndëretnik dhe ndërfitar. Disa veprime potenciale përfshijnë:

- Drejtimin e programeve të dialogjeve multi-fetare apo të lutjeve ndër-fetare.
- Përkrahjen e programeve që i edukojnë të rinjtë për historinë e bashkëjetesës multi-etnike në Prizren.
- Krijimin e platformave ku anëtarët e komuniteteve mund t'i ndajnë rrëfimet e tyre dhe përvojat e pajtimit.

- A do të ishit të hapur për bashkëpunimin në nisma të tilla si promovimi i dialogut dhe i paqes.

Në përfundim, dua ta shpreh që roli juaj si një udhëheqës shpirtëror juve ju vë në pozitë që të jeni një gurthemel në përpjekjet për ta ushqyer një të ardhme harmonike në Prizren, dhe në Kosovë në përgjithësi. Pres që të njihem me mendimet tuaja si dhe përkrahjen për këtë qëllim fisnik.

Përshëndetje të përzemërta

Dušan Radaković

**Ilir Deda, Aktivist i Shoqërisë Civile  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri At Milenković,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shqyrtojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e Shtërpçës si një vend i hapur për të gjithë njerëzit, që e përfshin bashkëjetesën multi-etnike dhe multi-fetare. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash, kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Jam i një bindjeje të fuqishme që harmonia ndërjetare duhet të ruhet dhe të përparohet më tutje. Kisha Ortodokse Serbe e ka një rol në ruajtjen dhe përparimin e kesaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurtëra dhe disa afatgjata që mund të ndërmerren nga ju dhe të vendosen si praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e mëparshme.

Në të kaluarën ka qenë një praktikë ku udhëheqësit fetarë ia kanë uruar publikisht njëri-tjetrit festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte një hap nismëtar drejt përparimit të respektimit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do të donte të thoshte respektim për festat më të rëndësishme fetare për anëtarët e bashkësive islamike.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh janë një formë moderne që synon ta përparojë bashkëjetesën dhe harmoninë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk vlerësohet kushedi se sa, unë besoj se është koha e duhur të vendoset dialogu ndërjetar në nivelin komunal lokal, dhe të fillohet krijimi i kulturës së paqes. Ky forum do ta përparonte mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, përfshirë mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ky po ashtu do të shërbente si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Unë besoj fuqishëm që udhëheqësia juaj si Vikar i Dioqezës së Prizrenit është e një rëndësie të madhe për zhvillimin e komunitetit suaj, për harmoninë ndërjetare dhe marrëdhëniet ndëretnike, dhe shpreh shpresën time se ju do t'i merrni parasysh veprimet e propozuara.

Me respekt,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë  
Instituti Evropian për Paqe  
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Vikar Milenković,

Quhem Senad Šabović dhe jam duke Ju shkruar si mbështetës i projektit të quajtur *Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë*, i udhëhequr nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Punoj si Këshilltar i Lartë me Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin parësor në përkrahjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile, të quajtur Alternativa Kosovare Civike (KCA – Kosovo Civic Alternative), e cila përpiket ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë.

Kjo letër ka për qëllim t'i shprehë pritjet e mia nga Ju për sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Parimet e shoqërisë multi-etnike janë të rrënjosura fuqishëm në sistemin ligjor dhe kushtetues të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë pritja kyçe e bashkësisë ndërkombëtare dhe janë mekanizmi parësor për mirëqenien e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, dhe në veçanti të komunitetit serb. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, të mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës paqësore duhet të jenë të pasqyruara në tërësi në jetën fetare të Kosovës. Lidhur me këtë është bërë mjaft shumë punë, por kjo duhet të forcohet dhe përhapet edhe më tutje, posaçërisht në këtë kohë të tendosjeve të rritura dhe të ngecjes në normalizim. Gjatë viteve, kam vërejtur me një vlerësim të lartë pjesëmarrjen aktive të Kishës Suaj në veprimtaritë e ndryshme të dialogjeve ndërfaqetare dhe të formave të ndryshme të kontributit për bashkëjetesën paqësore.

Unë dhe kolegët nga projekti do të donim, edhe t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, edhe t'ju ofrojmë disa sugjerime të reja në këtë drejtim. Unë i kuptoj shumë mirë, si pozitën unike të Kishës Ortodokse Serbe (SOC) në Kosovë, ashtu edhe ndjeshmëritë që e përcjellin këtë pozitë. Megjithatë, kontributi juaj aktiv për rritjen e ndjenjës së multi-etnicitetit dhe të tolerancës – ashtu siç ka ndodhur mjaft shpesh – do ta krijojnë një vlerë të shtuar domethënëse. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në një komunë me diversitet të tillë si Prizreni, që i ka disa nga objektet më të vlerësuara të trashëgimisë fetare të të gjitha feve në Kosovë. Kështu, qoftë nga aspekti i përgjigjes ndaj nismave të jashtme pozitive, apo në inicimin e vetë nismave tuaja, duhet të shfrytëzohet çdo mundësi për ta theksuar multietnicitetin si vlerë. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, ose përmbajtje të përbashkëta të mediave sociale, apo vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë apo institucionalë në qendrat dhe vendet e rëndësishme komunitare. Theksimi i mesazhit të tolerancës dhe respektimit të Fesë Suaj si ai i duhuri në angazhimet tuaja me besimtarët do të ishte po ashtu një mënyrë efektive e kontribuimit.

Në një mënyrë më konkrete, e kam propozuar krijimin e një këshilli ndërfaqetar i cili do ta koordinonte dhe këshillonte shtetin dhe donatorët ndërkombëtarë sa i përket mbrojtjes dhe rehabilitimit të vendeve të cenueshme fetare anembanë Kosovës. Ju dhe Kisha Juaj mundeni po ashtu të dëshironi ta shqyrtoni nismën e kësaj ndërmarrjeje, që mund të jetë posaçërisht e dobishme në Prizren. Kjo jo vetëm që do ta rriste mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu do ta rikonfirmonte në mënyrë të vazhdueshme mesazhin e tolerancës dhe të respektimit, që është pjesë përbërëse e Besimit.

I nderuari Vikar, jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i KCA-së, do të jenë të gatshëm që me kënaqësi t'ju ofrojnë përkrahje konkrete për zbatimin e sugjerimeve të dhëna këtu.

Me respektim dhe vlerësim të lartë,

Me respekt dhe vlerësim të lartë,  
Senad Šabović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë  
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Prishtinë, Kosovë**

I Nderuari Vikar, Staniša Milenković,

Qhem Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe Ligjerues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003–2016 kam qenë po ashtu edhe ligjerues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër jam duke ju shkruar për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndër-etnike në Kosovë.

Para së gjithash, shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë në shëndet e disponim të mirë. Këtë jam duke ua shkruar në emrin tim dhe të KIPRED-it, si dhe të disa organizatave të tjera me të cilat e ndajmë përkushtimin e përbashkët për forcimin e respektimit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, më përgjithësisht, dhe në komunën e Shtërpçës më në veçanti.

Siç jemi të vetëdijshëm shumë mirë, periudhat e ndryshme të historisë sonë të përbashkët janë shënuar me tendosje dhe konflikte, por po ashtu edhe me bashkëjetesë dhe bashkëpunim paqësor; dhe në të dyja komunitetet, kjo histori e jona është pasuruar nga një trashëgimi e thellë kulturore dhe shpirtërore. Jam i bindur që përmes vullnetit të mirë dhe bashkëpunimit ne mund ta çelim rrugën për një të ardhme ku komunitetet tona do të bashkekzistojnë në harmoni, duke punuar së bashku për të mirën e përbashkët. Për këtë qëllim, do të doja të propozoj disa nisma provuese të përbashkëta midis OJQ-ve tona dhe kishës suaj, që e synojnë promovimin e dialogut, të besimit dhe të bashkëpunimit midis shqiptarëve dhe serbëve.

Ne besojmë se këto nisma mund të marrin më shumë trajta, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar vetëm në):

1. **Dialogjet Ndërfetare dhe Shkëmbimet Kulturore**, ku anëtarët e të dyja komuniteteve do të bëhen bashkë për të mësuar për besimet, kulturën dhe vlerat e përbashkëta të njëri-tjetrit.
2. **Projektet e shërbimeve në komunitet**, ku shqiptarët dhe serbët do të punojnë së bashku në aktivitete nga të cilat do të përfitojë popullata lokale, të tilla si pastrimet mjedisore, ndihma humanitare, apo përkrahja e grupeve të cënueshme.
3. **Programet e angazhimit të rinisë**, ku të rinjtë e të dyja komuniteteve do të marrin pjesë në tryeza të rrumbullakëta, në ngjarje sportive, apo në projekte të artit, duke inkurajuar mirëkuptim të ndërsjellë dhe miqësi të qëndrueshme.

Ne besojmë se Kisha Ortodokse Serbe, si një institucion i respektuar me aftësinë për t'i bërë njerëzit bashkë përmes besimit, pasionit dhe dialogut, mund ta luaj një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në këto përpjekje. Ne jemi të bindur që me përkrahjen dhe drejtimin tuaj, këto nisma mund të ndihmojnë për ta krijuar një mjedis më paqësor dhe më përfshirës për të gjithë që jetojnë në Shtërpçë.

Ne do të jemi të nderuar nëse takohemi me ju për t'i diskutuar më tutje këto ide, si dhe për të hulumtuar për të tjera, dhe për të hetuar se si mund të bashkëpunojmë për t'i kthyer në realitet. Presim të dëgjojmë nga ju, dhe shpresojmë se së bashku do të ndërtojmë ura midis komuniteteve tona dhe do të lëvizim përpara në një të ardhme më paqësore.



Me respekt të thellë dhe përshëndetjet më të mira,

Mentor Agani

**Zoran Savič, Koordinator i Projekteve  
NGO AKTIV  
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Prift, Staniša Milenković,

Quhem Zoran Savić dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut. Edhe pse i lindur në Pulë, Kroaci, unë në fakt kam jetuar në Mitrovicë për 30 vjet dhe jam i përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore në Kosovë, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, meqë jam po ashtu edhe muzikant dhe kam marrë pjesë në projekte të ndryshme ndër-etnike me muzikantë të të gjitha etnive.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite me radhë kam punuar si gazetar në portalin Kosovo Sever – KosSev – dhe përmes kësaj pune jam bërë edhe më i afërt me situatën politike, të sigurisë, dhe atë fetare në Kosovë.

Kisha Ortodokse Serbe ka qenë gjithmonë gurthemel i komunitetit serb në Kosovë, duke e dhënë udhëheqjen dhe përkrahjen shpirtërore. Udhëheqja juaj në Kishën e Prizrenit juve ju vë në një rol kyç për nxitjen e harmonisë ndër-etnike. Nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta rrisë në një masë domethënëse unitetin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë në komunitetet tona. Ju nxis që t'i përkrahni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimit të përbashkët që i bëjnë bashkë njerëzit e prapavijave të ndryshme. Predikimet tuaja, së bashku me adresimet tuaja publike, duhet të vazhdojnë ta theksojnë rëndësinë e unitetit, tolerancës dhe të respektimit të të gjithëve.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multi-etnike dhe multi-fetare në Kosovë do të shndërrohen në normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet fetare përqafohen si fuqi, dhe jo si burime të ndarjeve. Për këtë qëllim, ju mund të përqendroheni në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet dhe tolerancë fetare, në përkrahjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit, dhe në sigurimin e përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Duke shikuar përpara, e parashoh një Kosovë ku bashkëjetesa multi-etnike dhe toleranca fetare janë të përvetësuara dhe të përqafuara. Takimet e rregullta ndër-fetare dhe nismat ndërkulturore mund ta nxisin dialogun dhe bashkëpunimin.

Këtë letër e përfundoj me një shënim shpresëdhënës, duke e paraparë një të ardhme ku përpjekjet tona të përbashkëta do ta kultivojnë një shoqëri mirëfilli harmonike dhe multi-etnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të vlefshëm.

Ju faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Savić



## Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Jovana Radosavljević, Ramadan Ilazi, Dušan Radaković, Ilir Deda,  
Senad Šabović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Imam Kujtim ef. Polloviqi  
Komuna e Shtërpçës

Nëntor 2024

**Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive**  
**New Social Initiative**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam, Kujtim ef. Polloviqi,

Jam duke ju shkruar me një respekt të thellë për punën dhe rolin tuaj jetik për Bashkësinë Islame në forcimin e mirëkuptimit, të dashamirësisë dhe të unitetit midis popujve të Kosovës.

Kohët në të cilat jemi duke jetuar janë sfiduese, ndërkohë që komunitetet anembanë Kosovës përpiqen ta gjejnë rrugën përmes vështirësive që kanë të bëjnë me identitetin, sigurinë, dhe bashkekzistencën. Në këto rrethana, udhëheqësit e besimit si ju e luajnë një rol thelbësor në udhëheqjen e komuniteteve drejt respektimit të ndërsjellë, dialogut dhe harmonisë. Përkushtimi juaj ndaj këtyre parimeve është një dëshmi e fuqisë së besimit në ndërtimin e urave dhe në shërimin e përçarjeve.

Si Imam, përpjekjet tuaja për t'i mbështetur dhe promovuar vlerat e tolerancës dhe të bashkekzistencës paqësore janë të një rëndësie të madhe jo vetëm për komunitetin tuaj, por po ashtu edhe për të gjithë ata që Kosovën e kanë shtëpi të përbashkët. Dialogu dhe bashkëpunimi ndërfetar janë thelbësor për krijimin e një shoqërie e cila e çmon diversitetin dhe e njeh humanitetin e përbashkët që na lidhe të gjithëve.

Unë besoj se përmes bashkëpunimit dhe nismave të përbashkëta, komunitetet e besimit mund të shërbejnë si flakadanë të shpresës dhe të unitetit. Qoftë përmes forcimit të dialogut ndëretnik, adresimit të sfidave të përbashkëta, apo përkrahjes së grupeve të cënueshme, ne e kemi mundësinë ta japim një shembull të asaj se si mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë mund të na çojë në një të ardhme më të ndritur për të gjithë ne.

Me respekt dhe falënderim të thellë,

Jovana Radosavljević

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Imam Polloviqi,

Udhëheqja juaj si një udhëheqës shpirtëror në komunitet është jashtëzakonisht e rëndësishme, dhe posaçërisht në këto kohë kur forcimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në Kosovë është më i rëndësishëm se kurrë.

Jam duke ju shkruar për t'i lavdëruar përpjekjet tuaja për promovimin e tolerancës dhe të respektimit të ndërsjellë përbrenda komunitetit dhe për t'i hetuar mundësitë që mund t'i forcojnë këto vlera më tutje. Në veçanti, unë besoj se udhëheqja juaj është kyçe në promovimin e dialogut ndërfaqetor.

Do t'ju propozoj që mundësisht të punojmë së bashku në përgatitjen e një koncepti për organizimin e dialogjeve të strukturuar midis udhëheqësve fetarë dhe pjesëtarëve të komunitetit nga prapavijat e ndryshme fetare për t'i adresuar keqkuptimet, për ta ndërtuar mirëkuptimin e ndërsjellë, dhe për ta forcuar bashkëpunimin në Komunën e Shtërpcës. Pos kësaj, ju sugjeroj zhvillimin e një programi edukativ për komunitetin për ta ngritur vetëdijen për rreziqet e keqinformimit, dhe posaçërisht të narrativave që e ushqejnë radikalizimin, dhe për t'i ofruar veglat për t'i vlerësuar në mënyrë kritike përmbajtjet online.

Udhëheqësia juaj në këto përpjekje do ta kishte një ndikim të thellë, meqë zëri juaj është thellësisht i respektuar dhe i besuar në kuadër të komunitetit. Do të isha i nderuar të takohem me ju për t'i diskutuar këto ide dhe për të hetuar se si mund të punojmë së bashku për ta forcuar mirëkuptimin dhe qëndrueshmërinë ndërfaqetare kundër ndikimeve të dëmshme.

Ju faleminderit për përkushtimin dhe shërbimin tuaj ndaj komunitetit. Pres përgjigjen tuaj.

Me respekt të sinqertë,

Ramadan Ilazi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv  
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)  
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam Kujtim ef. Polloviqi,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë në shëndet e disponim të mirë. Quhem Dušan Radaković, dhe shërbej si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC – Advocacy Center for Democratic Culture) në Mitrovicë. Unë jam duke ju drejtuar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një nismë kjo që synon t'i bashkojë njerëzit anembanë Kosovës duke e ushqyer dialogun, respektimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis të gjitha komuniteteve. Roli juaj i çmuar si një udhëheqës shpirtëror e ofron një mundësi unike për t'i frymëzuar dhe drejtuar përpjekjet për harmoni ndër-etnike në Kosovë.

Ndikimi i udhëheqësve fetarë si ju është instrumental për promovimin e vlerave të paqes dhe të bashkekzistencës. Si një përfaqësues i Bashkësisë Islame, udhëheqja juaj mund ta ushqejë pajtimin dhe mirëkuptimin.

- Si i parashihni komunitetet fetare duke i kontribuar procesit të shërimit dhe të unitetit midis grupeve të ndryshme etnike në Kosovë?
- A mundet Bashkësia Islame nën udhëheqjen tuaj të nisë programe edukative për t'i promovuar vlerat e tolerancës, të respektimit të ndërsjellë, dhe të pranimit ndër të gjitha besimet?
- Çfarë hapash besoni se janë të domosdoshëm për ta ushqyer bashkëpunimin midis udhëheqësve islamikë dhe udhëheqësve të besimeve të tjera, për aktivitete të përbashkëta për ndërtimin e komunitetit?

Shpresoj ta shoh një të ardhme ku komunitetet e ndryshme në Kosovë punojnë së bashku për ta ndërtuar një shoqëri të bazuar në besim, respektim, dhe në qëllime të përbashkëta. Udhëheqësia juaj në këtë proces do të ishte e paçmueshme.

- A do të ishte e mundur të organizohen veprimtari të përbashkëta kulturore apo humanitare me komunitetet e tjera fetare për ta treguar unitetin dhe vlerat e përbashkëta?
- A mund të shërbejë xhamia si një platformë për diskutimet dhe programet ndër-fetare të përqendruara në edukimin e të rinjve për trashëgiminë multi-etnike të Kosovës?
- Çfarë roli shihni për udhëheqësit islamikë në adresimin e sfidave me të cilat përballen grupet e marginalizuara në Kosovë?

Ju inkurajoj ta shqyrtoni udhëheqjen e nismave që i bëjnë bashkë njerëzit e të gjitha sferave të jetës, të tilla si:

- Drejtimin e programeve të dialogjeve apo ngjarjeve ndër-fetare në xhami.
- Përkrahjen e nismave të udhëhequra nga rinia që e theksojnë rëndësinë e tolerancës dhe të vlerave të përbashkëta.
- Partneritetin me udhëheqësit e tjerë fetarë për të avokuar për paqe dhe bashkëjetesë në forumet rajonale apo kombëtare.

Imam Polloviqi, ju falënderoj për marrjen parasysh të kësaj ftese për ta përkrahur bashkëjetesën ndër-etnike në Kosovë. Udhëhqja dhe përkushtimi juaj për promovimin e paqes dhe të

mirëkuptimit mund të frymëzojnë ndryshime domethënëse. I pres mendimet tuaja dhe mundësinë të punojmë së bashku në këtë ndërmarrje fisnike.

Përshëndetje të përzemërta,

Dušan Radaković

**Ilir Deda, Aktivist i Shoqërisë Civile  
Prishtinë, Kosovë**

I Dashuri Imam Polloviqi,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e bashkëjetesës multietnike dhe multifetare në Shtërpecë, si një zonë tejet e suksesshme multietnike dhe multifetare. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash, kur qëndrimet populliste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare ka qenë një ndër vlerat thelbësore të kombit tonë, dhe Bashkësia Islame e Kosovës e ka pasur një rol qendror në ruajtjen dhe përparimin e kësaj vlere. Besoj se janë disa veprime afatshkurtëra dhe afatgjata që mund të ndërmerren nga ju dhe të shndërrohen në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e kaluara.

Në të kaluarën, ka qenë një praktikë ku udhëheqësit fetarë ia kanë uruar publikisht festat më të rëndësishme fetare njëri-tjetrit. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte hapi fillestar drejt përparimit të respektimit ndër-fetar në vendin tonë. Kjo don të thotë respektim të festave më të rëndësishme fetare të anëtarëve të besimit ortodoks.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh është një formë moderne që synon ta përparojë bashkëjetesën dhe harmoninë ndërjetare. Edhe pse ne jetojmë në një kohë kur harmonia nuk vlerësohet aq shumë, unë besoj se Kosova, duke pasur parasysh historinë e saj unike, mund ta vendos dialogun e vet ndërjetar në nivelin komunal, për ta filluar krijimin e kulturës së paqes. Ky forum do ta përparojë mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, përfshirë mirëkuptimin me autoritetet lokale komunale. Ky po ashtu do të shërbejë si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Kosova do të jetë e suksesshme vetëm nëse e ruan karakterin e vet multietnik, dhe Bashkësia Islame e Kosovës e ka një rol kyç në ruajtjen dhe përparimin e këtij karakteri të shtetit tonë. Unë jam posaçërisht i interesuar të dëgjoj nga ju për punën e bërë për mbajtjen e harmonisë dhe mirëkuptimit ndërjetar në Shtërpecë.

Unë besoj fuqishëm që udhëheqja juaj është kritike në këtë pikë të zhvillimit të vendit tonë, dhe e shpreh shpresën që ju do t'i merrni parasysh veprimet e propozuara.

Me respekt,

Ilir Deda



**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë  
Instituti Evropian për Paqe  
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Imam Polloviqi,

Quhem Senad Šabović dhe jam duke ju shkruar si përkrahës i projektit të quajtur *Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë*. Punoj si Këshilltar i Lartë me Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin parësor në përkrahjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile, të quajtur Alternativa Kosovare Civike (KCA – Kosovo Civic Alternative), e cila përpiqet ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë.

Kjo letër ka për qëllim t'i shprehë pritjet e mia nga Ju për sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Siç e dimë, Republika e Kosovës është e përkufizuar si një shtet multietnik i të gjithë qytetarëve dhe i të gjitha komuniteteve të veta. Këto parime janë të rrënjësura fuqishëm në sistemin kushtetues dhe legal të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë pritja kyçe e partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe e sistemit organizativ të komunitetit euro-atlantik, drejt të cilave aspirojmë të gjithë. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, mirëkuptimit dhe bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen në tërësi në jetën fetare të vendit tonë. Lidhur me këtë është bërë mjaft shumë punë, por kjo duhet të forcohet dhe përhapet edhe më tutje, posaçërisht në këtë kohë të tendosjeve të rritura dhe të ngecjes në normalizim. Gjatë viteve, kam vërejtur me një vlerësim të lartë kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në kontekstin e kornizave të ndryshme të dialogut ndërfetar dhe të nismave të ndryshme të bashkëpunimit praktik ndërfetar. Takimet tona me Imamin Sahiti dhe me një numër të imamëve në komuna të ndryshme kanë qenë posaçërisht inkurajuese lidhur me këtë. Kolegëve të mi dhe mua na ka lënë përshtypje të fuqishme edhe numri i aktiviteteve që Bashkësia Islame e Kosovës i ka kryer lidhur me këtë, si dhe përkushtimi për të bërë edhe më shumë.

Unë dhe kolegët nga projekti do të donim, edhe t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, edhe t'ju ofrojmë disa sugjerime të reja në këtë drejtim. Thënë përgjithësisht, përdorimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, ose përmbajtje të përbashkëta të mediave sociale, apo vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë apo institucionalë në qendrat dhe vendet e rëndësishme komunitare. Lehtësimi i përfshirjes si dhe respektimi i diversitetit fetar dhe etnik në Predikimet e Xhumasë – e që jam i sigurtë se tashmë është duke ndodhur – do të ishte po ashtu një mënyrë efektive e kontribuimit. Më në veçanti, në disa nga letrat e mia paraprake kam propozuar krijimin e një këshilli ndërfetar i cili do ta koordinonte dhe këshillonte shtetin dhe donatorët ndërkombëtarë sa i përket mbrojtjes dhe riparimit të vendeve të cënueshme fetare anembanë Kosovës. Kjo jo vetëm që do ta shtonte mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu do ta rikonfirmonte vazhdimisht mesazhin e paqes, që është i rrënjësuar aq fuqishëm në besimin Mysliman, si në Kosovë, ashtu edhe anembanë botës.

I nderuari Imam, jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i KCA-së, do të jenë të gatshëm që me kënaqësi t'ju ofrojnë përkrahje konkrete për zbatimin e sugjerimeve të dhëna këtu apo të çfarëdo nisme përkatëse.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Šabović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë**  
**Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave**  
**Prishtinë, Kosovë**

I Nderuari Imam, Kujtim Efendi Polloviqi,

Quhem Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe Ligjerues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003–2016 kam qenë po ashtu edhe ligjerues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër jam duke ju shkruar për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndër-etnike në Kosovë.

Para së gjithash, shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë në shëndet e disponim të mirë. Këtë jam duke ua shkruar në emrin tim dhe të KIPRED-it, si dhe të disa organizatave të tjera me të cilat e ndajmë përkushtimin e përbashkët për forcimin e respektimit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, më përgjithësisht, dhe në komunën e Shtërpcës më në veçanti.

Ne e kuptojmë rolin kyç që udhëheqësit fetarë dhe të komunitetit e luajnë në forcimin e paqes, të mirëkuptimit dhe të pajtimit në kontekstin e Kosovës. Duke e pasur parasysh këtë, do të doja t'ju propozoj disa nisma që do të mund të ndërmerreshin nga ju dhe nga udhëheqësit e tjerë fetarë në Shtërpcë, si dhe nga autoritetet komunale, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët lokalë për ta çuar përpara respektimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin midis shqiptarëve dhe serbëve. Në vijim është një listë e nismave që besojmë se do t'i kontribuonte në një mënyrë domethënëse këtyre përpjekjeve: dhe, e qartë, ne nuk duhet të kufizohemi vetëm në to.

1. **Dialogjet Ndërfetare dhe Diskutimet Publike:** Organizimi i dialogjeve të rregullta ndërfetare ku udhëheqësit fetarë të komuniteteve fetare islamike, ortodokse, e të tjera, mund të angazhohen në bisedime të hapura dhe konstruktive për vlerat e përbashkëta, për mençurinë shpirtërore, dhe për atë se si besimi mund të jetë urë për në paqe. Këto diskutime duhet të jenë të hapura për publikun, ashtu që të përhapen në të tërë shoqërinë, duke e forcuar kështu një mirëkuptim më të thellë dhe duke i hequr keqkuptimet midis anëtarëve të komuniteteve të etnive dhe besimeve të ndryshme.
2. **Projektet e Përbashkëta të Bamirësisë dhe të Shërbimit ndaj Komunitetit:** Bërja bashkë e shqiptarëve dhe serbëve të prapavijave të ndryshme fetare për të punuar në nismat bamirëse nga të cilat përfiton komuniteti më i gjerë – të tilla si përkrahja e familjeve të cënueshme, përmirësimi i hapësirave publike, ofrimi i ndihmës humanitare, e kështu me radhë. Këto projekte do ta nxisin bashkëpunim dhe do të ndërtojnë besim midis grupeve të ndryshme përmes veprimeve të përbashkëta pozitive.
3. **Programet e Angazhimit të Rinisë dhe të Familjes:** Krijimi i mundësive për të rinjtë dhe për familjet e të gjitha prapavijave për të marrë pjesë në tryeza të përbashkëta të rrumbullakëta, në shkëmbimet kulturore dhe në aktivitete të tjera. Duke i angazhuar gjeneratat e ardhshme, ne do të krijojmë marrëdhënie të qëndrueshme dhe do ta ushqejmë kulturën e paqes dhe të respektimit. Një veprimtari e tillë mund të jetë, për shembull, shfrytëzimi i mundësive turistike të rrethinës së Shtërpcës, për organizimin e tryezave të rrumbullakëta ku të rinjtë shqiptarë dhe serbë do t'i diskutojnë mundësitë që një numër i tyre ta fillonin mësimin e gjuhëve amëtare të njëri-tjetrit.
4. **Kremtimet Publike Ndërfetare dhe Ngjarjet Kulturore:** Organizimi i takimeve apo ngjarjeve të përbashkëta për kremtimin e diversitetit kulturor dhe fetar të Shtërpcës, dhe

urimi i kremteve fetare anëtarëve të komuniteteve fetare përkatëse. Kjo mund të shoqërohet me deklarata të përbashkëta, me pjesëmarrje në lutje apo meditime të përbashkëta publike, dhe me këtë të gjithë udhëheqësit fetarë do ta japin një shembull të fuqishëm për të gjithë qytetarët e vet për ta përçafuar tolerancën, respektimin dhe bashkëpunimin, si elemente thelbësore të jetëve të tyre të përditshme.

Ne besojmë se përmes bashkëpunimit të komuniteteve fetare, të autoriteteve komunale, dhe të aktorëve të shoqërisë civile dhe të atyre lokalë, këto nisma mund ta bëjnë një ndryshim domethënës në përmirësimin e marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe serbëve. Udhëheqja juaj si drejtues i Bashkësisë Islame do të ishte thelbësore në drejtimin dhe promovimin e këtyre përpjekjeve.

Do të jem i nderuar të takohemi dhe t'i diskutojmë këto ide më tutje dhe të shikojmë si mund të punojmë bashkë për t'i zbatuar këto, si dhe për të gjetur edhe të tjera. Ju faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj, dhe pres të dëgjohemi dhe të bashkëpunojmë në këto nisma të rëndësishme.

Me respekt të thellë dhe përshëndetjet më të mira,

Mentor Agani,

**Zoran Savič, Koordinator i Projekteve**  
**NGO AKTIV**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam, Kujtim ef. Polloviqi,

Quhem Zoran Savič dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në fakt kam jetuar në Mitrovicë për 30 vjet dhe jam i përfshirë në mënyrë aktive në jetën shoqërore në Kosovë, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, meqë jam po ashtu edhe muzikant, dhe kam marrë pjesë në projekte të ndryshme ndëretnike me muzikantë të të gjitha etnive.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite me radhë kam punuar si gazetar në portalin Kosovo Sever – KosSev – dhe përmes kësaj pune jam bërë edhe më i afërt me situatën politike, të sigurisë, dhe atë fetare në Kosovë. Madje edhe sot unë bashkëpunoj me gazetarë dhe redaktorë të shumtë shqiptarë, si përmes projekteve, ashtu edhe përmes punëve që nuk janë të ndërlidhura me to.

Si pjesë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ju në një masë të madhe mund ta promovoni harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe i bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta ndihmojë tejkalimin e ndasive. Ju nxis që t'i përkrahni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që i bëjnë bashkë njerëzit me prapavija të ndryshme. Predikimet dhe adresimet tuaja publike mund ta theksojnë unitetin, tolerancën, dhe respektimin e të gjithëve. Prandaj, në të ardhmen e pres përkrahjen tuaj për organizimin e dialogjeve ndëretnike dhe të projekteve për shërbim të komunitetit që përfshijnë grupe të ndryshme fetare duke punuar së bashku.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike dhe multifetare në Kosovë do të shndërrohen në normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet fetare përvetësohen si fuqi, më parë se si burime të ndarjeve. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet dhe tolerancë fetare, në përkrahjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit, dhe në sigurimin e përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Këtë letër e përfundoj me një shënim shpresëdhënës, duke e paraparë një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri mirëfilli harmonike dhe multi-etnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të vlefshëm.

Ju faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Savič